

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“PARABOLA”SHPK

Sot me daten 13.07.2018 , unë ortaku i vetëm themelues:z.Benito Lanari , i biri i Antonios ,datëlindjes 11.03.1954, lindur në Itali, dhe banues në Itali, Adresa :” Denominare 7,14”, i pajisur me Letërnjoftimi me nr. AX1662909.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “,

Ka vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “PARABOLA “ Shpk*

Neni 1.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqëria do të quhet” PARABOLA” **SHPK.**

Neni 2

SELIA E SHOQERISE


Selia e shoqërisë është në adresën Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Nuredin Aliu”, ish UMB Fier, Fier.Shoqëria mund të hapë filial të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- Import, eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve,me shumicë dhe pakicë.
- Prodhim dhe tregëtim të konfeksioneve të ndryshme,carcaf,guverta,peceta.
- Prodhim dhe tregëtim të konfeksioneve të ndryshme,veshje,veshje pune
- Rrobaqepsi të konfeksioneve të ndryshme për të rritur dhe fëmijë.
- Tregëtim artikujve të ndryshëm industrialë.
- Tregëtim artikujve të ndryshëm lëkure
- Fasoneri



Neni 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise “ **PARABOLA**” SHPK eshte 100 (njëqindë) lekë. Ky kapital eshte i ndare ne 1 pjesë, e cila me vlere nominale 100(njemije) leke. Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

Z.Benito Lanari, zoteron 1 kuot baraz me 100 % te kapitalit.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

Neni 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqerise do te jete **Z. Benito Lanari**, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripërteritje.

Një Administrator tjetër mund të emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakut të vetëm, qe perfaqesone njëqindpërqind te pjeseve te kapitalit themeltar. Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

Administratori mund te kryej te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose te treteve pershkelje te ligjeve,statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 7

VENDIMET E ORTAKUT TE VETEM

Ortaku i vetëm i cili zotëron njëqind për qind të kuotave merr vendime të cilat janë të vlefshme sipas pikes 3 të nenit 81 të ligjit “Për shoqëritë Tregtare”.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim,

përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar ,te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven , si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjt e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregetar shqipetar.

Neni 10

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, ortaku themelues do ti drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PARABOLA” SHPK

ORTAKU I VETEM

Z. BENITO LANARI

